



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 75, datë 30.03.2023

**PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR. 16, DATË 31.01.2023 “PËR NJË
SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.152, DATË 22.12.2022
“PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E
BURSAVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2022-2023”**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike” i ndryshuar; shkresës nr.6478/54 prot., datë 11.11.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, protokolluar në Bashkinë Durrës me nr.9299 prot., datë 16.11.2022; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.522, datë 21.10.2022 “Për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për përfitim burse dhe pagese për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2022-2023” si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsimit Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.16, datë 31.01.2023, përsa i përket korrigjimit për nxënësin me nr. rendor 8, në tabelën 1, të pikës 1 “Miratimin e listës emërore të nxënësve të

Shkollave 9 vjeçare “Marie Kaçulini”, “Vadardhë”, “Bajram Gashi”, “Qemal Mici” , “Isuf Ferra” dhe “Neim Babameto” që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës, për vitin shkollor 2022-2023”, si më poshtë vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Kriteri	Shkolla	Arsyeja
8	Elisabeta Bardhok Mëmaj	2.3 g	9 vj “Bajram Gashi”	Korrigjim Emri

- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komuniteteve Fetare dhe Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 03.04.2023





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 232 prot.
3

Durrës, më 06 04 .2023

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

6423 2560/10

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.75 datë 30.03.2023 “Për miratimin e ndryshimit të VKB-së nr. 16, datë 31.01.2023 “Për një shtesë në Vendimin E Këshillit Bashkiak nr.152, datë 22.12.2022 “Për miratimin e listës emërore të nxënësve të arsimit parauniversitar, që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursave dhe pagesave për vitin shkollor 2022-2023”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

